

UDHËZIME MBI SISTEMIN TATIMOR PËR TË HUAJT

GUIDA FISCALE PER GLI STRANIERI

KODI TATIMOR E LLOGARIA TVA
CODICE FISCALE E PARTITA IVA

KONTRATAT PER QIRATË
CONTRATTI DI LOCAZIONE

BLERJA E SHTËPISË SË PARË
ACQUISTO PRIMA CASA

TRASHIGIMITË
SUCCESSIONI

SHLYERJET
RIMBORSI

KOMUNIKIME MBI PARREGULLSITË DOSJET E PAGESAVE
COMUNICAZIONI DI IRREGOLARITÀ CARTELLE DI PAGAMENTO

UDHËZIME MBI SISTEMIN TATIMOR PËR TË HUAJT

KODI TATIMOR E LLOGARIA TVA.....	2
KONTRATAT PER QIRATË.....	6
BLERJA E SHTËPISË SË PARË.....	11
TRASHIGIMITË	15
SHLYERJET	18
KOMUNIKIME MBI PARREGULLSITË DOSJET E PAGESAVE.....	20

KODI TATIMOR E LLOGARIA TVA

KODI TATIMOR

Çfarë është ?

Kodi tatimor identifikon qytetarin në të gjitha raportet me Entet e me Administratën Shtetërore. Për ta marrë duhet të prezantohesh në zyrat lokale në Agjencinë e të Ardhurave me një dokument njohje. Për të huajt duhen pasaporta, ose leja e qëndrimit, e vlefshme.

Per te porsalindurit kodi fiskal jepet nga Komuna në momentin e regjistrimit në regjistrin e gjëndjes civile

KUJDES :

I vetmi kod tatimor (fiscal) i vlefshëm është ai i leshuar nga Agjencia e të Ardhurave. Asnjë person i jashtëm është i autorizuar të krijojë programe software për riprodhimin e kodit ose të stampojë teseren.

Nëse humbas teseren?

Nese tesera humbet ose vidhet, mund të kerkohet një dublikatë, çdo zyrë lokale të agjencisë. Për ndryshe për të evituar rradhën dublikata mund të kërket:

- a) me internet: mjafton të hyhet në sito www.agenziaentrate.gov.it, klikare në Servizi, të zgjidhet opzione Codice Fiscale e të plotësohen hapsirat me të dhënat personale;
- b) nepermjet shërbimit automatik të informacionit (numeri telefonit 848- 800333).

Mbas disa ditësh pritje tesera arrin me posten prioritare. Në rast ndryshimi të vendbanimit (rezidencës) duhet të drejtoheni në zyrën lokale për të komunikuar të dhënat e reja, duke prezantuar letërnjoftimin me ndryshimin e bërë ose nepërmjet një autoçertifikate.

ÇFARË ËSHTË LLOGARIA TVA?

Llogaria TVA i identifikon pronarit taksapagues një aktivitet ekonomik në të gjithë lidhjet me Entet e me administratën shtetërore e me të gjithë operatorët e tjerë ekonomik.

Numeri i Llogaria TVA lëshohet nga “Agenzia delle Entrate” në momentin e per-

caktimit të pozicionit IVA i cili mbetet i pandryshuar deri në mbylljen e aktivitetit. Duhet të shënohet në deklaratimet tatimore dhe në çdo dokument ku kërkohet.

ÇFARË DUHET TË BËHET KUR FILLOHET NJË AKTIVITET?

Përsoneat të cilët fillojnë të ushtrojnë një aktivitet për një ndërrmarrje, art ose një profesion duhet të kërkojnë dhënien e “PARTITA IVA” ne një nga zyrat lokale tek Agenzia delle Entrate duke prezantuar një deklaratë të veçantë për fillimin e aktivitetit, brenda 30 ditësh nga fillimi i aktivitetit, i krijimit të një firme, shoqate, duke ndjekur shënimet që i bashkëngjiten formularve.

Modelet të cilët shërbejnë për komunikimin e fillimit të një aktiviteti mund të gjenden në sito internet të Agencisë (www.agenziaentrate.gov.it). Do të përdoren:

- modeli AA7/8 për subjekte të ndryshëm nga përsonea fizik (shoqata, firma, etj);
- modeli AA9/8 për përsonea fizik (ndërrmarrje individuale e punetorë autonom).

Deklarata për fillimin e aktivitetit mund të prezantohet:

- drejtpërdrejtë në një nga zyrat tek Agenzia delle Entrate në dy kopje, duke paraqitur një dokument njohje;
- me anë të postës me rekomandim, në një kopje, por duke bashkëngjitur një dokument njohje;
- personalisht me internet duke kërkuar kodin PIN nga zyrat ose nga sito <http://telematici.agenziaentrate.gov.it>, ose nga një ndërmjetës i kualifikuar duke përdorur shërbimin Entratel.
- Pranë Zyrës së rregjistrimit të ndërrmarrjeve e vendosur pranë Dhomave të Tregtisë, Industrisë, Artizanatit Agrar, por vetëm nga ana e subjekteve që duhet të rregjistrohen në rregjistrin e ndërrmarrjeve ose që duhet të bëjnë denoncimin në repertorin e lajmeve ekonomike e administrative (REA)

KUR TË DHËNAT MBI AKTIVITETIN EKONOMIK NDRYSHOJNË ÇFARË DUHET TË BËHET?

Nëse gjatë veprimtarisë ndryshojnë disa nga elementet e aktivitetit të filluar, ose mendohet të mbyllet ky aktivitet, taksapaguesi duhet të prezantojë një Deklaratë mbi Ndryshimin (DICHIARAZIONE DI VARIAZIONE) brenda 30 ditësh nga ky ndryshim në një nga zyrat lokale tek Agenzia delle Entrate, duke përdorur të njëjtin model të parashikuar për fillimin e aktivitetit.

Shoqatat duhet të prezantojnë një kopje origjinale të verbalit të asamblesë që ka vendosur ndryshimin e statutit.

CILAT JANË DETYRIMET E TITULLARIT TË LLOGARISË TVA?

1. Mbajtja e rregjistrave kontabile

Rregjistrat e kontabilitetit të detyrueshëm të mbahen për përcaktimin e IVA (TVA) në rregjistrimin e veprimtarisë aktive (shitjeve) e pasive (blerjeve) janë rregjistri i faturave të dhëna e rregjistri i faturave të marra, dhe për rastet e parashikuara rregjistri i kompensimeve.

2. Faturimi

Është e detyrueshme mbajtja e faturave për çdo veprim, si:

- në rastin e veprimarisë tregtare me pakicë (p.sh dyqanet ushqimor...) fatura zevendësohet nga kuponi;
- në veprimtari të shërbimeve (p.sh restorante, lavanderi...) është e zevendësuar nga dëftesa fiscale.

Pronarët e vegjël që punojnë me rregullën e veçantë të qesimit (ose me një vëllim pune me më pak se 10.329,14euro) janë të detyruar të japin fatura vetëm kur e kërkon klienti.

3. Deklarimi

Cilido që ka numer llogarie TVA duhet të prezantojë deklaratën e te ardhurave vjetore model UNICO çdo viti. Kjo është e detyrueshme edhe për ato persona që nuk kanë pasur asnjë të ardhur ose që nuk kanë dhënë o marrë asnjë faturë.

4. Derdhjet

Nga një janari 2007 të gjithë titullarët e numërit të llogarisë janë të detyruar të bëjnë derdhjet fiskale e detyrimet për sigurimet shoqërore vetëm në rrugë telematike, me modelin F24

NDIHMAT

Personat fizik të cilët fillojnë një aktivitet të ri si ndërmarrje, ose si pune autonome me pagesa ose me fitime të kufizuara gjatë vitit (limitet janë të ndryshme sipas aktivitetit), mund të perfshihen në rregullën e ndihmës tatimore duke perdorur thjeshtime në dokumentat e llogarit e duke derdhur një taksë zevendësuese mbi të ardhurat.

Subjekte të tillë njëkohësisht mund të kërkojnë ndihmë në zyren lokale në Agjencinë e te Ardhurave e cila do të vendos në dispozicion një tutor që do të ndihmojë në të gjitha veprimet fiskale e kontabile.

CILAT JANË DETYRIMET E TJERA

Dhoma e Tregtisë

Dhënia e llogaria TVA përcakton detyrimin e rregjistrimit në Rregjistrin e Ndërrmarrjeve (Registro delle Imprese) i vendosur pranë Dhomës së Tregtisë.

Të rregjistruarit janë të detyruar, brenda afatit të përcaktuar për të paguar paradhënien e pare të taksës mbi të ardhurat, e drejta vjetore e parashikuar nga normat në fuqi.

Pagesa duhet të përsëritet çdo vit në të njëjtën skadencë.

INPS

Tregtarët e artizanët të cilët fillojnë një aktivitet ekonomik janë të detyruar të rregjistrohen në INPS (Instituti i Sigurimeve Shoqerore) e duhet të derdhin kontributet për sigurimet shoqerore.

Derdhja e tyre bëhet nepërmjet formularit F24- **on line**.

KONTRATAT PER QIRATË

SI RREGJISTROHEN KONTRATAT E DHËNIES E MARRJES ME QIRA TË PASURISE SË PALUAJTSHME

Se pari mund të thuhet se rregjistrohen të gjitha kontratat per çfarëdo shume por me kohëzgjatje mbi 30 dite në vit. Qiratë e pasurive të paluajtshme duhet të rregjistrohen detyrimisht brenda 30 diteve nga data e rregjistrimit të praktikës ose nga fillimi i efekteve, edhe se të mëparshme.

SA PAGUHET PËR RREGJISTRIMIN?

për pasuritë urbane të paluajtshme	2% të qirasë vjetore
për pasuritë urbane me qira konkordata*	2% mbi shumën përkatëse vjetore ne masen 70%
per pasuritë e natyrës prodhuese **	1% të shumës vjetore shumëzuar me numrin e pagesave vjetore

* Bëhet fjale per kontratat e qirave të banesave (me afat minimi 3 vjet, por me të drejtë shtyerje të afatit edhe 2 vjet të tjera) e kontrata të banesave të natyrës tranzitore për studenta universitarë (me afat minimumi 6 muaj e maksimumi 36) në lidhje me pasuritë e vendosura në komuna të veçanta me popullsi të madhe (tensione abitativa) qeraja e të cilave është e percaktuar sipas kritereve të konkorduara mes shoqatave si pronare e banorve.

** tarifa e 1 % i referohet qirave të pasurive të natyrës prodhuese e zbatuar nga qiradhënës në cilësinë e subjektit Iva. Nëse qiradhënësi nuk është subjekt Iva, qiraja i nënshtrohet taksës së regjistrimit me 2% e parashikuar zakonisht për qiratë.

Për kontratat e qirave e nënqirave të pasurive urbane me afat shumëvjeçar pagesa e taksës mund të kryhet ndryshe:

- nga viti në vit, brënda 30 ditëve nga skadenca e pagesës vjetore të mëparshme, duke zbatuar 2% për secilën pagesë vjetore e duke llogaritur edhe rritjet ISTAT
- Në një shumë të vetme, brënda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, duke i zbatuar 2% shumës së caktuar për gjithë kohëzgjatjen e kontratës. Në këtë rast ka një zbritje mbi taksën e duhur të barabartë me gjysmën e taksës të interesit legal (2,50 përqind) shumëzuar me vitet e kohëzgjatjes së kontratës.

Për ato që zgjedhin derdhjen e taksës së regjistrit në **një shumë të vetme**, llogaritur mbi shumën përkatëse për gjithë kohëzgjatjen e kontratës, sidoqoftë taksa nuk mund të jetë inferiore a **67,00 Euro**. Ndërsa për ato që zgjedhin, derdhjen vjetore, taksa për vitet e ardhshëm edhe mund të jetë inferiore a 67,00 Euro.

SHEMBULL 1:

Taksa e regjistrimit e detyrueshme $5.000,00 \times 70\% = \text{Euro } 3.500,00 \times 2\%$
 = **Euro 70,00**

SHEMBULL 2:

Nëse qiraja vjetore e përcaktuar është 3.500,00 euro
 taksa rezulton të jetë Euro 49,00 ($3.500,00 \times 70\% = \text{Euro } 2.450,00 \times 2\%$
 = Euro 49,00)
taksa më e vogël që duhet të paguhet është 67,00 Euro

Garancia nuk i nënshtrohet taksës së regjistrimit. Nëse garancia është dhënë hua nga një i tretë që s'ka lidhje me kontratën do të duhet një taksë propocionale (në masën 0,50%) të shumës së garancisë.

Qiradhënësi e qiramarrësi i pergjigjen së bashku pagesës së taksës e cila është në ngarkim për te dy.

Ja zbritjet për pagesat dyvjeçare:

Afati i kontratës (vit)	Gjysma e taksës interesi legal aktuale	Zbritjet në %
6	1,25%	7,50%
5	1,25%	6,25%
4	1,25%	5,00%
3	1,25%	3,75%
2	1,25%	2,50%

SHEMBULL:

Nëse për një pronë urbane qiraja vjetore është Euro 3.000,00 dhe kontrata është 4 vjeçare taksapaguesi mund të bëjë një pagesë vjetore për seicilin nga 4 vitet, e llogaritur sipas shkronjës a)-d.m.th me një pagesë të vetme Euro 228,00 – e llogaritur sipas shkronjës b).

- a) 2% di Euro 3.000,00 = Euro 60,00 (për vitin e parë duhet të paguhet shuma minimale 67,00 Euro; për vitet e mëvonshme shuma prej 60,00 Euro)
- b) 2% di Euro 3.000,00 x 4 pari a 2% di Euro 12.000,00 = Euro 240,00
Duke hequr zbritjen e 5% (1,25% x 4) = Euro 12,00
taksa = Euro 228,00

me një kursim prej Euro 12,00

Nëse është paguar për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës, për prishje të parakohshme te saj, bëhet shlyerja për vitin në vazhdim dhe atij qe vjen më pas.

Nëse qiradhënsi jep fatura me IVA (taksë) mbi qiranë që merr, kontrata nuk i nënshtrohet taksës së rregjistrimit e mund të rregjistrohet duke aplikuar taksën fikse prej Euro 67,00.

PAGESA E TAKSËS

Para se ti prezantojnë për ti rregjistruar kontratat palët kontratuuese duhet të llogarisin taksën që duhet të derdhin tek agjenti i vjeljes së taksave, bankë o zyrë postale duke përdorur formularin F23. Kopja e vertetimit të pagesës dorëzohet brënda 30 ditëve nga data e kontratës o nga dhënia me qera, që mund të jetë e mëparshme, tek Agenzia delle Entrate sëbashku me kërkesen e rregjistrimit (mod. RR e 69) të plotësuar e cila shpërndahet pranë kësaj Agjencie.

RASTE TË TJERA PAGESASH

Për mospagim, shtyerje, prishje të parakohshme të kontratave të rregjistruara, palët kontraktuese duhet të paguajnë taksën e duhur brenda 30 ditëve nga ngjarja, duke përdorur mod.F23 në të cilin duhet të paraqesin me saktësi të dhënat e rregjistrimit të kësaj kontrate (viti, seria e numeri i rregjistrimit të ndara nga vija) e të prezantohet vertetimi i pagesës ne Agjencinë kompetente brënda 20 diteve sëbashku me “njoftimin” për të cilat jepet faksimile për ta plotësuar taksapaguesi.

Taksa është 67,00 Euro për mospagime pa kompensim dhe për prishje të parakohshme, ndërsa është e barabartë me 2% të qerasë vjetore minimumi 67,00 Euro për formalitetet për shtyerjen. Nuk bëhet asnjë pagese kur kontrata është regjistruar për rast “perdorimi” si qera subjkt IVA

SANKSIONET

Kur nuk bëhet rregjistrimi duhet të paguhet një sanksion nga 120% deri në 240% të taksës. Por financa ofron mundësinë e reduktimit të sanksionit në 1/8 nëse taksapaguesi parashikon pagesen brënda 90 diteve nga skadenca e rregjistrimit; 1/5 nëse paguan brenda një viti. Kur vonon pagesen dëmshpërblimi është i barabartë me 30% të taksës e me të njëjtat reduktime të mësipërme.

ÇFARË DUHET PËR RREGJISTRIMIN

- Një origjinale e një fotokopje (ose disa origjinale) të praktikës që do të regjistrohet;
- pull takse prej Euro 14,62 i cili vëndoset çdo 100 rreshta në origjinalen e në kopjet
- dy modele të shpërndara nga Agenzia delle Entrate:
 - a) formular të kërkesës së rregjistrimit - mod.69;
 - b) listë e praktikave të prezantuara për rregjistrimin- mod.RR;
- vërtetim i pagesës së bërë - mod.F23.

Nga 2007 pagesa e taksës së pullës bëhet nga ndërmjetës të caktuar (p.sh në cigareshitës) nga Agenzia delle Entrate të cilët japin kartela të veçanta telematike që zëvendësojnë, me të gjitha efektet, pullat e taksës.

Kodet e taksave më të përgjithshme, të vendosura në faqen mbrapa të F23, janë:

- 115T taksë rregjistri për kontratat e qirave të ndërtesave-1°pagesë vjetore
- 112T taksë rregjistri për kontratat e qirave të ndërtesave - pagesa e vitit të dytë
- 107T taksë rregjistri për kontratat e qirave të ndërtesave o subjete me IVA - gjithë periudha
- 114T taksë rregjistri për shtyerje të afatit të kontratave (dhenie ose marrje me qira)
- 113T taksë rregjistri për prishje të parakohshme të kontratës (dhenie ose marrje me qira)
- 110T taksë rregjistri për mospagim të kontratave (dhenie ose marrje me qira)
- 108T taksë rregjistri për qiratë e fondeve nga fshati
- 964T detyrim fiks Euro 3,72 për çdo kopje
- 671T sanksione administrative në para taksë rregjistri

Perveç shënimit korrekt të kodeve tatimor në modelin e pagesës F23 duhet të shënohet kodi i zyres e shkaku, i cili për rregjistrimin e praktikave është RP.

RREGJISTRIMI NË RRUGË TELEMATIKE

Rregjistrimi i kontratave të qirave duhet të bëhet detyrimisht në rrugë telematike nga pronarët që zotrojnë mbi 100 prona (ndërtesa e toka).

Ndërsa është fakoltative për të gjithë taksapaguesit e tjerë.

Rregjistrimi i kontratave të qirasë (e pagesa e taksave) në rrugë telematike është i përshtatshëm dhe i favorshëm. Ndryshe nga sistemi tradicional i cili parashikon në fakt, më parë pagesën e taksës në bankë ose në postë, e më pas prezantimin në zyrën e Agenzia delle Entrate me kërkesen për rregjistrim, software i veçantë i vënë në dispozicion nga Agjencia lejon, në fakt, rregjistrimin një kontratë qiraje të çfardoshme me përdorimin e thjeshtë të procedurës telematike, rehatisht nga shtëpia ose duke ngarkuar një ndërmjetës të kualifikuar në trasmetimet telematike të praktikave.

Për informacione më të hollësishme mund të konsultohet në sito internet të Agencisë www.agenziaentrate.gov.it.

BLERJA E SHTËPISË SË PARË

Financa tregon vëmendje për ata që blejnë për të parën herë një pronë të plotë, një banesë për përdorim ose për përfitim, duke parashikuar ndihma të konsiderueshme tatimore në reduktimin e taksave të rregjistrimit, hipotekale e kadastrale o IVA per ti aplikuar vlerës së deklaruar në praktikën e transferimit.

Në shitjet e pasurive **për përdorim banesë** (e lidhjeve përkatse) të zbatuara ndaj personave fizik që nuk ushtrojnë aktivitete tregtare, artistike o profesionale, baza e tatueshme nga taksa rregjistri, hipoteke e kadastrale mund të formohet nga vlera kadastrale e pasurisë, në vend të shumës së paguar me kusht që në praktikën e bërë të jepet vlefte efektive për kalimin.

Vlera katastrale përcaktohet duke shumëzuar rentën katastrale (rivlersuar me 5%) me koeficientin 110 (shtëpi e parë)

Sa kursehet:

Taksa	Kuota e Zakonshme	Kuota e ndihmës	Kursimi
Rregjistri	7%	3%	4%
Hipoteke	2%	168,00 Euro	të ndryshme
Kadastrale	1%	168,00 Euro	të ndryshme

Nëse blihet nga një ndërmarrje “ndërtimi” (ose një ndërmarrje që ka rikonstruktuar pronën) e blerja bëhet brënda 4 viteve nga përfundimi i punimeve, IVA dotë jetë 4% mbi çmimin e blerjes në vend të 10% me një kursim prej 6% e taksat e duhura për rregjistrimin do të jenë në masën fikse (168,00 Euro seicila).

SHEMBULL n.1

Çifti Rossi blejnë me anë të një akti zyrtarë një ndërtesë në Canicattì, për banim, duke paguar 50.000,00 Euro.

Duke kërkuar ndihmën “Prima Casa” ata paguajnë taksë mbi aktin Euro 1.836,00 në vend të 5.000,00 Euro, duke kursyer Euro 3.164,00.

nëse çifti Rossi do të blinte nga një ndërmarrje ndërtimi të njëjtën ndërtesë me të njëjtën shumë do të paguanin IVA 2.000,00 euro në vend të 5.000,00 Euro, duke kursyer 3.000,00 Euro, përveç taksës së rregjistrimit, hipotekare e kadastrale në masën fikse gjithsej 504,00 Euro.

ÇFARË MUND TË BLIHET

Ndihmat “Shtëpia e Parë” u përkasin:

- ndërtesave urbane për banim të klasifikuara nga kadastra në kategorinë nga A1 në A9, si dhe A11, vetëm nëse këto nuk prezantojnë karakteristika të “banesave luksoze”;
- ndërtesa në ndërtim (në gjëndje të papunuar) o rikonstruktime, për ti bërë kryesisht banesa jo luksoze;
- pjesë ndërtese të blera me anë të ndihmës si garazh o vend auto (C6), magazina ose depozita (C2), hangare të mbyllur ose të hapur (C7), një për seicilin tip edhe me akte të ndara.

ÇFARË DUHET TË BËHET PËR TË PËRFITUAR NDIHMEN “SHTËPIA E PARË”

Për të përfituar këto avantazhe fiskale është e nevojshme që blerësi të deklarojë në aktin, gati në dekadencë, që:

- prona ndodhet në territorin e Komunes në të cilën është ose në të cilën do të stabilizojë rezidencën e vet, brënda 18 muajve nga blerja, o ku ka qëndren ose ku zhvillon aktivitetin kryesor ose, nëse është transferuar për punë, në të cilën ka qëndrën punëdhënësi;
- nuk është titullar i vetëm ose se bashku me bashkshorten e të drejtës së pronës, për përfitim, përdorim e banesë, të shtëpive të tjera banimi në Komunën ku ndodhet prona që do të blejë;
- nuk është titullar, as me kuotat, edhe në rregjim të bashkimit legal, në të gjithë territorin nazional, e të drejtës së pronës, për përfitim, përdorim, të ndonjë pasurie tjetër të blerë edhe nga bashkëshorti/tja, me ndihmën “shtëpi e parë”.

SHEMBULL n. 2:

Bashkshortët Rossi kanë mundur të blinin një banesë në Canicattì duke përfituar ndihmen “shtëpi e parë”, megjëse shtëpia që kanë blerë nuk është “luksoze”, kanë ndërmend të transferojnë rezidencën e tyre në Canicattì, asnjëri prej tyre nuk ka pasuri tjetër në këtë qytet dhe asnjëri prej tyre nuk ka banesë në pjesë të tjera të Italisë të blerë me të njejtat ndihma.

KUJDES:

Por çfarë ndodhë në qoftë se:

- bëjnë deklarata të rreme në akt;
- nuk transferohet brënda 18 muajve rezidenca në komunën ku ndodhet prona;
- transferohet – me detyrime ose falas – prona e blerë me ndihma para se të kalojnë 5 vjet nga blerja (përveç kur e blen edhe një herë brënda vitit).

Humbet këto ndihmat!!!

Në këtë rast zyra vazhdon marrjen e tatimeve të duhura në masën e zakonshme, me shtesë 30%, për sanksionet, përveç kamatëvonesës.

SHEMBULL n. 3:

Bashkshortët Rossi për probleme familiare vëndosën të shesin apartamentin në Canicattì para se të kalojnë 5 vjet, e nuk blejnë shtëpi tjetër brënda vitit.

Në këtë rast, Agenzia delle Entrate do të rikuperojë diferencën mes tatimit të llogaritur në momentin e blerjes me ndihmë dhe tatimeve të llogaritura në mënyrë të zakonshme. Duke bërë llogaritë Z.Rossi do të paguajnë 3.164,00 Euro vlerë së cilës i shtohet 30%, edhe interesi.

SHEMBULL n. 4:

Në qoftë se Z.Rossi vendosin të blejnë, brënda një viti nga rishitja, një shtëpi tjetër të parë, Agenzia delle Entrate nuk do të kërkojë të rikuperojë tatimet si në shembullin e mësipërm, por do tu njohë atyre një skonto të barabartë me tatimin e regjistri të paguar në aktin e parë. Do të jenë ato që do të vendosin se si do ta përdorin.

Në fakt në qoftë se shitet prona e blerë me ndihmën “Shtëpi e Parë” e brënda një viti nga kjo shitje blihet një tjetër banesë jo luksoze, mundë – duke u mbështetur në kushte të tjera- të kërkohet përsëri ndihma “Shtëpi e Parë”. Në këtë rast është e drejta për kredi tatimi, (bonus skonto në shembullin n.4), të barabartë me taksën e rregjistrimit ose me IVA ndihmëse e paguar në aktin e parë.

Kjo skonto mund të përdoret:

- në uljen e taksës së rregjistrimit në aktin e dytë;
- në uljen, për të gjithë kreditin, të taksës së rregjistrimit, hipoteke e kadastrë, të detyrueshme mbi aktet ose denoncimet e mëvonshme;
- në uljen e Irapf të detyrueshëm;
- në kompensimin e shumave të detyrueshme ex art. 17 legje n. 241/97.

Kjo kredi është personale, jo e ndashme e jo e kthyeshme.

TRASHIGIMITË

KUSH DUHET TË PREZANTOJË DEKLARATË TRASHIGIMIE

Trashigimtarët, me ligj ose me testament, të një personi të vdekur pronar i pasurive të tundeshme e te patundshme.

KUR

Brënda **12** muajve nga data e fillimit të trashigimisë (d.m.th nga data e vdekjes).

KU

Pranë zyres tek Agenzia delle Entrate kompetente në bazë të rezidencës së fundit të të vdekurit.

SI

Duhet të plotësohet në disa kopje mod.4 i cili kërkohet tek Agenzia delle Entrate e të bashkëngjiten këto dokumenta:

- 1) çertifikata e vdekjes;
- 2) çertifikatë e gjendjes familiare e të vdekurit dhe e trashigimtarve;
- 3) tabela e taksave të autolikuiduara (p.sh taksa hipoteke e kadastre) me faturat e pagesave të bëra.

Zyra, mbas rregjistrimit u kthen kopjet për seicilin dokument trashigimtarve, të cilët duhet të parashikojnë prezantimin e tyre brënda 30 diteve në Zyren e Territorit.

TATIMET

Duke filluar nga 3 tetor 2006 mbi trasferimet e pasurive dhe e të drejtave për shkak vdekje është vendosur taksa mbi trashigiminë

Tarifat e reja e franchigia (që do të thotë vlera brënda së cilës përjashtohesh nga pagesa e taksës mbi trashëgiminë) aplikohen mbi vlerën e përgjithëshme neto të pasurive (d.m.th vlera e pasurive dhe e të drejtave objekt trashigimie neto me zbritjen e defiçiteve e detyrimeve si për shembull borxhet e personit të vdekur, shpenzimet mjeksore e të varrimit).

Ato diferencohen në bazë tipit të raportit që lidh të vdekurin me trashëgimtarin, që mund të jetë bashkëshortësi, farefisni ose afri në linjë të drejtë ose anësore deri në një farë grade, ose të një tjetër tipi.

Taksa e trashëgimisë aplikohet:

- ndaj bashkëshortit e të afërmve në linjë të drejtë mbi vlerën e përgjithëshme neto të tepërt, për seicilin përfitues, 1.000.000,00 Euro(franchigia): 4%;
- ndaj vëllezërve e motrave mbi vlerën e përgjithëshme neto të tepërt për seicilin përfitues, 100.000,00 Euro (franchigia): 6%;
- ndaj të afërmve të tjerë deri në të katërt gradë e të afrive në linjë të drejtë, si dhe afrive në linjë anësore deri në gradën e tretë: 6%;
- ndaj personave të tjerë: 8%.

Ndërsa në rastin a), për bashkëshort e të afërm në linjë të drejtë, është parashikuar një franchigia prej 1.000.000,00 Euro, në rastin b), për vëllezër e motra, është parashikuar një franchigia prej 100.000,00 Euro, në rastet c) e d) nuk është parashikuar asnjë lloj franchigia.

Kur në aktin trashigimor ka pasuri të patundëshme ose të drejta reale mbi pasuritë, përveç taksës mbi trashigiminë janë të detyrueshme edhe taksë hipoteke e kadastre.

Këto janë të barabarta respektivisht, me **2%** e me **1%** të vlerës së pasurisë, me një pagesë minimumi **168,00 Euro**. Nëse vlera është deklaruar në masë inferiore me atë të përcaktuar nga kadastra, Zyra nuk mund të bëjë retifikimin e vlerës. Nëse brënda pasurisë së trashëgueshme ndodhet një pronë (jo luksoze) që do të përdoret si “shtëpi e parë”, është parashikuar pagesë taksë hipoteke e kadastre në masë fikse (**168,00 Euro** për seicilën taksë). Për të përfituar këtë ndihmë duhet që të paktën njëri nga trashigimtarët të plotësojë kushtet, si rrjedhim edhe bashkëtrashigimtarët e tjerë përfitojnë indirekt.

Kodet e taksave për likuidimin e praktikave të trashëgimisë:

	kodi i taksës
Taksë trashëgimie – vlerë globale neto	004T
Taksë trashëgimie – kuota e trashëgimit	001T
Tatim hipoteke 2%	649T
Tatim kadastre 1%	737T
Taksë hipoteke Euro 35,00 (për çdo ruajtje)	778T
Taksë pulle Euro 58,48 (për kopjim)	456T
Taksë pulle Euro 14,62 (për çdo model 240)	456T

N.B në rastin kur taksat e dhurimit, hipotekare e kadastrale rezultojnë më të vogla se 168,00 Euro duhet sidoqoftë të paguhen taksat fikse minimumi 168,00 Euro.

KU DUHET TË BËHET PAGESA

Pranë zyres për vjeljen e taksave, në çfardo banke o zyre postale me mod. F23, duke shënuar kodin e zyres e causale SA.

RISHIKIM AKTIV

Nëse deklarimi mbi trashigiminë është prezantuar brënda 90 ditëve mbas afatit të parashikuar për të ndrequr këtë vonesë duhet të paguhet sanksioni i reduktuar me 1/8 e taksës së duhur; por kur ndreqja bëhet brënda një viti nga data e skadencës së prezantimit të deklaratës reduktohet 1/5 e minimumit. L'Agenzia delle Entrate është e ngarkuar me detyren e trasmetimit të kopjeve të deklaratave të trashigimisë në Komunen ku ndodhet pasuria me qëllim zbatimin e I.C.I. (taksë plotësuese mbi pasurinë).

SHLYERJET

SI MUND TË MERRET NJË SHLYERJE

SHLYERJA E NDALESAVE DHE DERDHJET DIREKTE TE TAKSAVE

Taksapaguesi mund të kërkojë kthimin e e ndalesave direkte ose të pagesave të bëra, kur ka bërë një gabim material në llogaritjen e shumës së derdhur o në plotësimin e modelit të derdhjes ose kur ka bërë dy herë të njëjtën pagesë, për më tepër, kur detyrimi tatimor nuk ekziston plotësisht ose pjesërisht. Kërkesa mund të prezantohet në letër të thjeshtë e bashkëngjitur me kopjen e dëftesës së ndalesës së bërë ose kopjen e modelit të pagesës.

Në qoftë se bëhet fjalë për shlyerje të ndalesave direkte (art. 37 del D.P.R n. 602 del 1973), kërkesa bëhet brenda 48 muajve nga data e bërjes së ndalesës.

Në rast ndalese, kërkesa për shlyerje mund të bëhet si nga subjekti që ka bërë derdhjen ashtu edhe nga përceptuesi i shumave të nënshtruara ndalesave. Edhe kur flitet për kthime të pagesave direkte (art. 38 del D.P.R. n.602 del 1973), kërkesa bëhet brenda 48 muajve nga data e bërjes së pagesës.

Për pagesat në lidhje me tatimet indirekte afati i fundit për të bërë kërkesën për shlyerje është 36 muaj nga data e pagesës.

SHLYERJET IVA

Çfarë duhet të dihet

Pagesa IVA mund të kërkohet për kredi që rezultojnë:

- nga deklarimi vjetor IVA edhe në formë unifikuese;
- nga tejkalimi i ndalesave të tremujorit.

Për të patur të drejtën e kthimit të parave taksapaguesi duhet të plotësojë kushte të veçanta.

Mënyra e kërkesës

Për të marrë shlyerjet e kredisë që rezultojnë nga deklarimi vjetor taksapaguesi duhet të prezantojë tek agjenti i vjeljes së taksave kompetente për provincën në të cilën ndodhet nga 1 shkurti, një kërkesë të veçantë në dy esemplarë (model VR) brënda afatit të scadencës të deklarimit vjetor IVA.

Konsiderohen të vlefshëm modelet VR të prezantuara brënda 90 diteve nga skadenca e afatit të parashikuar për prezantimin e deklarimit vjetor IVA, edhe në formë të unifikuar përveç aplikimit të sanksioneve të parashikuara nga ligji.

Për të marrë shlyerjet e kredisë që rezulton nga likuidimi i tremujorit, taksapaguesi duhet të prezantojë në Zyrën tek Agenzia delle Entrate kompetente për territorin kërkesën e veçantë sipas modelit të aprovuar nga Drejtori i Agjencisë.

Kjo kërkesë duhet të prezantohet në dorë ose me rekomandim me kuitancën e kthimit, o në rrugë telematike me Entratel, brënda ditës së fundit të muajit që vjen pas tremujorit për të cilin bëhet fjalë. Nuk konsiderohen të vlefshme kërkesat e prezantuara pas këtij afati.

Garancitë

Për të marrë shlyerjet e IVA(s) është e nevojshme, përveç subjekteve që janë të përjashtuar, të paraqitet garanci (fideiussione, polizza fideiussoria) firmosur nga përfaqësuesi legal ose nga pronari i firmës e lëshuar nga ndonjë bankë kredie, nga një ndërmjetës financiar ose shoqëri sigurimesh.

Në rast autoçertifikacioni për përjashtim të prezantimit të garancisë, për të ashuquajturit “taksapaguesa virtuoz” duhet të jetë i bashkëngjitur Mod.VR, për shlyerjet vjetore, ose kërkesa për shlyerjet gjatë vitit.

Mënyra e shpërndarjes

Shlyerjet vjetore që nuk i kalojnë 516.456,90 Euro derdhen drejtëpërdrejtë nga koncesionari i vjeljes së taksave duke filluar nga 41°ditë mbas prezantimit të Mod. VR. Në rast kërkesë për shlyerje të një shume më të madhe, koncesionari do të parashikojë pagesën deri në shumën e mësipërme dhe pjesa që mbetet do të paguhet më vonë nga Zyra e të Ardhurave kompetente.

KREDITIM I SHLYERJEVE NË LLOGARINË RRJEDHËSE

Për shpejtimin e shlyerjeve është e mundur të kërkohet kreditim në c/c bankar ose postal.

Kërkesa mund të bëhet në çdo zyrë lokale e cila merr koordinatat e llogarisë rrjedhëse të kërkuesit. Mund të kërkohet kreditim në llogarinë rrjedhëse edhe me internet: për këtë është e nevojshme rregjistrimi në sito Agenzia dell'Entrate dhe marrja e kodit Personal, PIN

KOMUNIKIME MBI PARREGULLSITË DOSJET E PAGESAVE

KOMUNIKIMET E PARREGULLSIVE

Çfarë janë?

Komunikimet për parregullsitë arrijnë nga kontrollet formale e automatike të deklarimeve e informojnë taksapaguesin mbi gabimet e gjetura, duke i dhënë mundësi për rregullimin e tyre me pagesën e një sanksioni të reduktuar.

Çfarë bëhet?

Taksapaguesi i cili nuk është dakord me tatimin e përcaktuar në komunikimet që arrijnë nga:

- **kontrollet automatike** mund të drejtohet:
 - në cilën do zyrë në Agencinë e të Ardhurave duke dhënë elemente që provojnë korrektësinë e të dhënave të deklaruar;
 - në qendrën e asistencës telefonike n. 848.800.444.
- **nga kontrollet formale**, duhet ti drejtohet zyrës kompetente, d.m.th asaj që ka dërguar komunikimin, për të sqaruar të dhëna o elementë të cilët nuk janë konsideruar ose vlersuar gabimisht nga vetë zyra

Taksapaguesi që njeh parregullsitë mund të rregullojë pozicionin e vet duke derdhur importet e duhura, brënda 30 ditëve nga marrja e komunikimit sipas kësaj tablele:

Komunikimet e parregullsive

Tatimi

Interesi

Sanksioni reduktuar(në1/3)e taksës për për kontrollet automatike e 2/3 e taksës për kontrollet formale)

Kompensime me kredi të tjera: PO

Si e ku paguhet?

Ku paguhet	Si paguhet
Banka	Model i gatshëm
Zyrë poste	Model i gatshëm
Agjenti i vjeljes taksave	Model i gatshëm

Për titullarët e llogarise TVA është e detyrueshme bërja e pagesës në rrugë telematike

KUJDES:

Komunikimet mbi parregullsitë nuk janë procesverbale të verteta jopozitive, për këtë mund të kundërshtohen përpara Komisionit Tatimor.

DOSJET E PAGESAVE

Çfarë janë?

Dosjet ose tabelat e pagesave, të njoftuara nga koncesionarët e grumbullimit të taksave nepërmjet punonjësve të vet, ose të dërguara me rekomandim, përbajnë kërkesen për të paguar brënda 60 diteve shumat e regjistruara mbas kontrollit, të çdo tipi e sipas verifikimeve të bëra nga administrata financiare (përfshirë pjesën e kompensimit në favor të agjentit të vjeljes së taksave).

Tabelat e pagesave përbajnë gjithashtu, datën në të cilën lista hyn në fuqi, përshkrimimin e borxheve me motivet përkatëse, e udhëzime mbi mënyrën e pagesës si dhe sqarimet të tjera për mënyrat se ku mund të kërkojmë ndihmën e duhur.

Në rast mos pagese brënda afatit prej **60 ditëve**, mbi shumat e regjistruara në listë zbatohen interesa vonese nga data e komunikimit të dosjeve, si dhe kompensimi i plotë në favor të agjentit. Me kalimin e afatit agjenti i vjeljes së taksave mund të fillojë veprimet e procedurat për mbledhjen detyruese mbi të gjithë pasurinë e kreditorit e të detyrimeve të tij (si p.sh, bllokimi administrativ i pasurive të regjistruara dhe sekuestrimi i pasurisë)

Çfarë bëhet?

Taksapaguesi pasi kontrollon tabelen, nëse mendon që është e saktë mund ta paguaj në sportelet e koncesionarit, të bankës o në zyren postale.

Në qoftë se dëshiron më shumë informacion, mund të drejtohet:

- në zyren e Agjencise së të Ardhurave e cila ka nxjerrë vendimin;
- në qendrën e asistencës telefonike n. 848.800.444.

KUJDES:

Jo të gjitha dosjet e pagesave u përkasin taksave shtetore në kompetence të Agjencise së të Ardhurave, shumë përmblajnë kërkesa për të paguar gjoba për kundravajtje rrugore, sanksione administrative të llojeve të ndryshme, taksa komune, kontribute të sigurimeve shoqërore, etj. Taksapaguesi duhet të ketë kujdes ti drejtohet entes përgjegjëse për debitin, e caktuar si ente tatimore në tabelë.

A mund të kundërshtohen dosjet?

Me tu kontrolluar dosja, se taksapaguesi e konsideron të pasaktë borxhin mund të prezantojë në zyren që ka marrë vendimin një kërkesë vetëmbrojtëse për anulimin, total ose të pjesshëm të debitit. Nga ana tjetër, brenda 60 diteve nga njoftimi i dosjeve, taksapaguesi mund të prezantojë kërkesë Komisionit Tatimor, sipas udhëzimeve të dhëna në këtë dosje.

KUJDES:

Kërkesa për vetëmbrojtje nuk ka efekt pas përfundimit të afateve; për këtë taksapaguesi duhet të ketë kujdes të mos kalojë 60 ditët për tu drejtuar tek Gjykata Tatimore.

Në rast mospagimi brenda 60 ditëve nga njoftimi i tabelave concesionaria do të fillojë mbledhjen e detyruar.

A mund të pezullohet pagesa?

Taksapaguesi që ka prezantuar kërkesë, në pritje të përgjigjes të Komisionit Tatimor mund ti bejë kërkesë për pezullim kësaj të fundit (pezullim gjygsor) ose në zyrën e Agjencise së të Ardhurave kompetente për territorin; kërkesa bëhet në letër të thjeshtë e duhet të niset e bashkëngjitur nje kopje të proçesverbalit të aktit të kundërshtimit si dhe një kopje te kërkesës së bërë

A mund të paguhet me këste

Taksapaguesi në situatë vështirsie të përkohshme mund të kërkojë pagimin me afat të gjatë të shumave të rregjistruara në vendet e emëruara në tabelen e pagesave. Kërkesa për këste bëhet në leter me vulë e shoqëruar me dokumentacionin përkatës e duhet të prezantohet gadi në fund, para se të fillojë proçedura ekzekutive. Kërkesa prezantohet në zyrën financiare kompetente e cila ka bërë listen në bazë të vëndbanimit fiskal, e cila, me të shqyrtuar situaten e taksapaguesit, mund të lejojë deri në 60 këste, ose të pezullojë vjeljen e taksave për një vit e pastaj jep mundësinë e pagimit me afat deri në 48 këste.

Në qoftë se shuma e rregjistruar është më e madhe se 25.822,00 Euro, për të pasë ndarjen në këste është e nevojshme të kërkohet një garanci bankare o siguruese

INFORMAZIONE TË VLEFSHME

QËNDRA E ASISTENCËS MULTICANALE (CAM)

PËR TU LIDHUR ME OPERATORËT TANË
NGA E HËNA DERI TË PREMTEN NGA ORA 9 DERI NË OREN 17
E TË SHTUNËN NGA ORA 9 DERI NË ORËN 13 NË NUMERAT:

848.800.444 (shërbim me operator)

848.800.333 (shërbim automatik)

800.100.645 (numër verde dedikuar shlyerjeve- rimborsi)

199.148.398 (numër për të kontaktuar CAM me celular)



ZYRAT LOKALE

“TROVA L’UFFICIO” PËR TË GJETUR ME LEHTËSI ZYRËN E DUHUR :

www.agenziaentrate.gov.it/servizi (në seksionin “Contatti”)

848.800.333 (shërbim automatik)

RREGJISTRIME E TAKIME

PËR TË EVITUAR PRITJET E KOTA NË SPORTELE

[www.agenziaentrate.gov.it/servizi /cup/index.htm](http://www.agenziaentrate.gov.it/servizi/cup/index.htm)

199.126.003 (shërbimi automatik) AKTIV 24 ORË.

Cassetto fiscale (per sqarime mbi të dhënat e përfshira në këtë cassetto)

SITO INTERNET

PËR INFORMACIONE, FORMULAR, NORMATIVA, SHËRBIME ON-LINE

www.agenziaentrate.gov.it

WEB MAIL @

PËR INFORMACIONE E ASISTENCË ME E-MAIL

[www.agenziaentrate.gov.it/comunicare/contact/ center/index.htm](http://www.agenziaentrate.gov.it/comunicare/contact/center/index.htm)

CALL BACK

PER TË RREGJISTRUAR NJË THIRRJE DUKE ZGJEDHUR DITEN E ORËN

www.agenziaentrate.gov.it/servizi (në seksionin “Contatti”)

848.800.444 (shërbim me operator)

SMS

PËR TË MARRË NJË INFORMACION MBI TATIMET NË CELULAR
TË DËRGOHET NJË SMS NË NUMERIN **320.43.08.444**

*Traduzione a cura di
Pranvera Paruca*

*Perkthyer nga
Pranvera Paruca*

Finito di stampare
nel mese di dicembre 2007
Tecnolito grafica - Trento

GUIDA FISCALE PER GLI STRANIERI

A cura della Direzione Centrale Servizi ai Contribuenti
in collaborazione con la Direzione Provinciale di Trento

Si ringrazia il CINFORMI - Centro Informativo per l'Immigrazione
della Provincia Autonoma di Trento per la collaborazione nelle traduzioni
a cura di "Città aperta - Società Cooperativa Sociale".
Via Vicenza 5 - 38068 Rovereto (TN).

Questa pubblicazione tradotta in albanese
è distribuita gratuitamente, fino ad esaurimento, dall'Agenzia delle Entrate.

Aggiornata con la normativa in vigore a novembre 2007.

Per ulteriori informazioni e aggiornamenti: www.agenziaentrate.gov.it

